



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 48/2026

Datë: 04/05/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 65 (paragrafi 1, 2, 3 dhe 4) të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik si dhe në përputhje me nenin 11 (paragrafi 4) të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil për interes të institucionit

1. Znj. Venera Maksuti, nga pozita aktuale Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave në Divizionin për Koordinim të Politikave në Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, transferohet përhershëm brenda të njëjtës kategori të shërbimit civil për interes të institucionit në pozitën: Zyrtare e Lartë për Politikat Kundër Dhunës në Familje në Divizionin për Qasje në Drejtësi, Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Gruas dhe Dhuna në Baza Gjimore në Departamentin për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale, dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit.
2. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësit sipas pagës së pozitës në të cilin është transferuar.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Në zbatim të Rregullores ZKM nr. 10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, dhe për shkak të nevojës për plotësimin e pozitës si dhe në interes të institucionit, më datë 15.04.2026 është paraqitur kërkesa për transferim të përhershëm të nëpunëses civile znj. Venera Maksuti. Transferimi bëhet brenda të njëjtës kategori profesionale, nga pozita Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave në Divizionin për Koordinim të Politikave, në kuadër të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, në pozitën Zyrtare e Lartë për Politikat Kundër Dhunës në Familje në Divizionin për Qasje në Drejtësi, Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Gruas dhe Dhuna në Baza Gjimore, në kuadër të Departamentit për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit.

Në mbështetje të nenit 65 (paragrafi 1,2,3 dhe 4) të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke u bazuar në kërkesën e arsyetuar për këtë transferim, dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësja civile, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ridvan Hoti

Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi u dërgohet:

- Znj. Venera Maksuti;
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale, dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.